

Të dashur lexues dhe lexuese!

Ne ju ftojmë të zbuloni në bibliotekën tonë mbi 64.000 tituj:

- a. Libra (letrarë dhe jo letrarë)
- b. Libra për fëmijë dhe të rinj
- c. Revista
- d. Libra për tu dëgjuar (në CD)
- e. Lojëra
- f. Lojëra me kompjuter
- g. DVD / Disqe blu-ray
- h. CD
- i. Paketa të plota (p.sh. kurse gjuhësh)
- j. Libra në gjuhë të huaja
- k. Libra elektronikë (E-books)

Për më tepër ne ofrojmë edhe

- a. Aktivitete
- b. Akses në internet
- c. Shërbim fotokopje
- d. Vende për të mësuar

Orari i punës:

<b>Ditët e javës</b>	<b>nga - në</b>
E hënë	10 – 18
E martë	13 – 18
E mërkurë	---
E enjte	10 – 18
E premte	13 - 18
E shtunë	
E diel	

Ju presim me dëshirë të na vizitoni!

Stafi i bibliotekës

## Rregullat e përdorimit

Për t'ju bërë sa më të lehtë përdorimin e bibliotekës, do të dëshironim t'ju jepnim disa informacione bazë. Të gjithë përdoruesit janë të lutur të lexojnë kushtet e mëposhtme për përdorimin e librave dhe mjeteve të tjera të bibliotekës sonë dhe të konfirmojnë njohjen e tyre me nënshkrim në fund.

### **1. Regjistrimi:**

Regjistrimi i lexuesve kryhet personalisht. Për regjistrimin janë të nevojshme:

- a. një mjet identifikimi me fotografi
- b. një formular regjistrimi („Meldezettel“)
- c. dorëzimi i formularit të plotësuar

Nëpërmjet nënshkrimit, çdo përdorues deklaron se i njeh kushtet e marrjes së librave e mjeteve të tjera me qira, si dhe bie dakord me aksesimin në sistem të të dhënave personale, sipas rregullave në fuqi për ruajtjen e të dhënave. Nuk u jepen asnjëherë të dhënat e përdoruesve, palëve të treta dhe nuk kryhen analiza të lidhura me emra personash konkretë.

Fëmijët deri në moshën 18 vjeç mund të regjistrohen vetëm me anë të një deklaratë me shkrim nga kujdestarët e tyre ligjorë, lidhur me përgjegjësitë përkatëse. Në këtë mënyrë, ata detyrohen të paguajnë tarifat e papaguara, apo të zëvendësojnë, në raste dëmsh nga ana e personit që kanë nën kujdestari.

Në momentin e regjistrimit merret në dorëzim një kartë, e cila shërben për të marrë hua libra apo mjete të tjera nga biblioteka. Karta nuk është e transferueshme.

Ndryshimet e emrit apo të adresës, jeni të lutur të na i njoftoni. Në rast se humbni kartën, duhet të njoftoni menjëherë bibliotekën. Kundrejt një tarife, do të mund të pajiseni me një kartë tjetër.

### **2. Huamarrja**

- a. Afatet e marrjes hua:

Lloji i artikullit	Afati i huamarrjes
Libër	4 javë
CD	4 javë
Lojëra me kompjuter	4 javë
DVD / Disk Blu-ray	1 javë
Paketa të plota (p.sh. kurse gjuhësh)	4 javë
Libra elektronike (E-Book)	3 javë
Libra elektronike për tu dëgjuar (E-Audio)	1 -2 javë
Letër elektronike (E-Paper)	2 orë

- b. Artikujt që nuk mund të merren me qira (p.sh. vepra reference) janë të shënuara qartë.
- c. Numri maksimal i artikujve që mund të merren me qira (njëkohësisht) për çdo përdorues është i kufizuar:  
Maks. 2

- d. Përdoruesit janë të detyruar të regjistrojnë artikujt e përzgjedhur përpara se t'i marrin me vete.
- e. Artikujt janë të destinuar vetëm për përdorim vetjak, duhet të trajtohen me kujdes dhe nuk lejohet tu jepen palëve të treta apo të shumëfishohen e të publikohen.
- f. Në rast shumëfishimi, përgjegjësia për shkeljen e të drejtave të autorit, bie mbi përdoruesin. Shumëfishimi i librave të plotë, revistave, apo partiturave muzikore, është i ndaluar. Kopjimi i artikujve audiovizivë është gjithashtu i ndaluar. Në rast kopjimi apo printimi të informacioneve që gjenden në internet, duhet të mbahen në vëmendje të drejtat e të tretëve.
- g. Përdoruesit duhet t'i kontrollojnë artikujt për probleme apo dëmtime të dukshme, përpara se sa t'i marrin në dorëzim.
- h. Biblioteka nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për dëmtime të pajisjeve, të të dhënave apo mbajtësve të të dhënave të përdoruesve, që mund të vijnë nga përdorimi i artikujve.
- i. Afati i marrjes hua duhet të respektohet. Nëse kalohet ky afat, aplikohen gjoba për kalim afati.
- j. Nëse artikujt nuk janë porositur nga dikush tjetër, afati i kthimit mund të zgjatet maksimalisht 2 x personalisht në bibliotekë, nëpërmjet telefonit (03691 – 73 49 678) ose me anë të postës elektronike ( [bibliothek@eisenach.de](mailto:bibliothek@eisenach.de) ). Afati "i ri" fillon të llogaritet nga dita në të cilën është kryer zgjatja e afatit.
- k. Humbja ose dëmtimi i artikujve duhet t'i bëhet i ditur bibliotekës. Në të tilla raste, duhet të kryhet dëmshpërbimi. Në rast se humbasin vetëm pjesë të artikujve të përbërë nga shumë elementë, duhet të zëvendësohet i gjithë artikulli. Edhe shkrimi, nënvizimi apo nënshkrimi në libra apo artikuj të tjerë, konsiderohen dëmtime.
- l. Për më tepër, për zëvendësimin e artikujve duhet paguar edhe një tarifë shërbimi.
- m. Nëse artikulli që ju kërkoni nuk është aktualisht në bibliotekë, ai mund të rezervohet, kundrejt një tarife përkatëse.

### **3. Tarifat:**

<b>I. Tarifat e regjistrimit</b>	<b>Kostot</b>
Të rritur	20,00
Të rinj deri në 18 vjeç	0,00
Fëmijë deri në 14 vjeç	0,00
<b>II. Karta vjetore</b>	
Karta familjare	
Karta zëvendësuese në rast humbjeje	5,00
<b>III. Karta ditore</b>	
<b>IV. Tarifat individuale</b>	
<b>V. Tarifat e rezervimit</b>	<b>1,00</b>
Për çdo artikull	
<b>VI. Tarifa e shërbimit</b>	
<b>VII. Gjoba për kalim afati</b>	<b>0,50 – 1,00</b>
<b>VIII. Tarifa për njoftim vonese</b>	
Njoftimi i parë	
Njoftimi i dytë	
Njoftimi i tretë	

#### **4. Rregullat e brendshme**

- a. Përdoruesit duhet të sillen në mënyrë të tillë, që të mos shqetësojnë të tjerët, apo t'i privojnë ata nga përdorimi i shërbimeve të bibliotekës.
- b. Fëmijët duhet të mbikqyren nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë, gjatë qëndrimit në bibliotekë.
- c. Pirja e duhanit në ambientet e bibliotekës është e ndaluar.
- d. Ngrënia dhe pirja në ambiente të tjera është e ndaluar.
- e. Ndalohet kryerja e telefonatave.
- f. Udhëzimet e personelit të bibliotekës janë të detyrueshme për tu ndjekur.
- g. Drejtuesit e bibliotekës kanë të drejtën të përjashtojnë përkohësisht ose plotësisht nga përdorimi i ambienteve të bibliotekës, personat që shkelin në mënyrë të vazhdueshme rregullat e brendshme, pa qenë të detyruar të kthejnë tarifat vjetore të paguara për anëtarësim.
- h. Nuk mbahet përgjegjësi për garderobën apo objekte të tjera me vlerë.

## FORMULAR REGJISTRIMI

Unë konfirmoj se i njoh rregullat e bibliotekës **Stadtbibliothek Eisenach** dhe do u përmbahem atyre.

Unë marr përsipër t'i përdor artikujt e marrë hua, duke respektuar ligjet për të drejtën e autorit.

Unë bie dakord me përpunimin elektronik të të dhënave të mia personale, sipas rregullave përkatëse për përdorimin dhe marrjen hua.

Mashkull:Femër:

Grada / titulli akademik:

Mbiemri / mbiemrat:

Emri / emrat:

Emri i kujdestarit ligjor:

Rruga:

Kodi postar | Qyteti:

Numri i telefonit:

Posta elektronike (E-Mail):

Datëlindja:

\_\_\_\_\_, më

Nënshkrimi:

(Në rastin e lexuesve deri në 18 vjeç, nënshkrimi i kujdestarit ligjor)